

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTVENDIMIN “PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1137, DATË 16.12.2020 “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT 2021–2025 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2021-2023”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Parandalimi dhe goditja e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të Qeverisë Shqiptare. Qëllimi i hartimit të këtij projektvendimi është reflektimi i ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe institucional të miratuara pas hyrjes në fuqi dhe implementimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021–2025 dhe të planit të veprimit 2021–2023 me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1137, datë 16.12.2020.

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është gjithashtu orientimi i politikave dhe forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, mbrojtjen, ndjekjen, reagimin ndaj akteve terroriste dhe organizatave terroriste si dhe rehabilitimin/riintegrimin e grupeve vulnerabël të këtyre fenomeneve.

Ndryshimet dhe shtesat në strategjinë ekzistuese synojnë reflektimin e përgjegjësi të strukturave strukturave, agjencive dhe institucioneve që kanë përgjegjësi në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Përmes këtij projektakti do të synohet gjithashtu edhe krijimi i kapaciteteve hetimore të profileve të eksponentëve të ndryshëm ekstremistë dhe strukturave të posaçme në organizimin strukturor të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me qëllim rikonceptimin dhe vendosjen e saj pjesë të agjencive të inteligjencës së antiterrorit, si Policia e Shtetit, SHISH, AISM etj.

Dokumenti i strategjisë është pasuruar me objektiva strategjike dhe objektiva të tjera specifike veçanërisht për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm, në shtyllën/qasjet e parandalimit dhe reagimit. Strategjia do shoqërohet me masa konkrete për realizimin e objektivave dhe përcaktimin e mekanizmave implementues dhe koordinues. Realizimi i qëllimeve të politikave do të mbështeten përmes dy planeve të veprimit specifikisht planin e veprimit për

parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm 2022-2025 dhe planin e veprimit për luftën kundër terrorizmit 2022-2025.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektakt lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe me dokumentet e tjera strategjike. Projekt vendimi është parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2022-2024 dhe në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2022.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Propozimi i këtij projektakti vjen si pasojë e disa ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe institucional si miratimi i ligjit nr. 41/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, në nenin 7 të këtij ligji, i cili ndryshon nenin 75/a të këtij Kodi, u përcaktua kompetenca lëndore e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në nenin 135 të Kushtetutës. Në sferën e juridiksionit të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar u përfshinë edhe gjykimi i veprave penale me qëllime terroriste sipas neneve vijuese: *neni 230 "Vepra me qëllime terroriste", neni 230/a "Financimi i terrorizmit", neni 230/b "Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin", neni 230/c "Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit"; neni 230/9 "Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur"; neni 231 "Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit"; neni 232 "Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste"; neni 232/a "Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste"; neni 232/b "Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste"; neni 233 "Krijimi i turmave të armatosura"; neni 234 "Prodhimi i armëve luftarake"; neni 234/a "Organizata terroriste"; neni 234/b "Banda e armatosur".*

Kalimi i kompetencës së hetimit të veprave me qëllime terroriste nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm tek SPAK ka sjellë edhe nevojën e reflektimit të

---

Relacion shpjegues mbi projektvendimin “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021–2025 dhe të planit të veprimit 2021–2023”

kësaj përgjegjësie të re në implementimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit.

Gjithashtu ndryshimi i kuadrit strategjik vjen dhe në sajë të ndryshimeve në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm me miratimin e Vendimit të Këshilli i Ministrave nr. 604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme” ku në pikën 3, germa “d” përcaktohet se, Ministria e Brendshme është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore edhe në fushën e ekstremizmit të dhunshëm.

Gjithashtu miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 237, datë 20.4.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 737, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)” ka përcaktuar se QKEDH do të jetë përgjegjëse për koordinimin e planit të veprimit kundër ekstremizmit të dhunshëm në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.

Aktualisht janë në fuqi dy strategji që rregullojnë respektivisht fushën e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në vitin 2021 para ndryshimeve dhe kalimit të ekstremizmit të dhunshëm në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme u vlerësua e nevojshme që të rishikohej kuadri strategjik në fushën e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm nën koordinimin e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me qëllim që kuadri i ri strategjik t’i përgjigjet dinamikave të zhvillimit të fenomenit të përhapjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojnë në terrorizëm. Por me ndryshimet e fushës së përgjegjësisë pas një analize të hollësishme të dy dokumenteve strategjike atij aktual për fushën e terrorizmit dhe atij në draftim për fushën e ekstremizmit, bazuar edhe në praktikën e shumë vendeve të zhvilluara, u vlerësua e nevojshme që të dy dokumentet strategjike të harmonizohen në një dokument të vetëm strategjik duke përfshirë veprimtarinë e gjithë institucioneve përgjegjëse në funksion të objektivave të përbashkëta të parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit dhe pasojave të tyre. Një qasje e përbashkët me fokus tek parandalimi, duke konsideruar përmasat e deritanishme të fenomenit të terrorizmit dhe ekstremizmit do të sjellë një impakt më të ndjeshëm në minimizimin e kërcënimit terrorist dhe kapaciteteve shtetërore për reagim.

Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër terrorizmit e pasuruar me objektivat strategjikë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe masat e tjera legislative dhe politike në kuadër të kësaj fushe janë të ndërlidhura me Prioritetin e Qeverisë të parashikuara në SKZHI 2015-2020, gjithashtu ndërlidhet me procesin e integritimit Evropian dhe si e tillë është pjesë e PKIE-së për vitin 2022-2024.

Ndryshimi dhe pasurimi i kësaj strategjie është në harmoni të plotë me Strategjinë së BE-së kundër terrorizmit në nenet 5, 82 dhe 84, të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ku është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet vendit tonë dhe BE-së në fushën kundër terrorizmit do të bazohet përsëri në një qasje me katër komponentë ku pjesë e komponentit të reagimit do të jetë edhe rehabilitimi dhe riintegrimi:

- a) Sinjalizimi/parandalimi
- b) Hetimi dhe goditja
- c) Reagimi, Rehabilitimi dhe Riintegrimi
- d) Mbrojtja

Për arritjen e këtij qëllimi politike që është pasuruar edhe me komponentët e rehabilitimit dhe riintegritimit theksi do të vihet në ndërprerjen e akteve terroriste përpara se ato të kryhen, duke përdorur një përgjigje të koordinuar nga shteti në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. Çdo reagim duhet patjetër të marrë në konsideratë faktin se një sulm terrorist nuk mund të jetë i suksesshëm nëse hartohen planet e emergjencave në përputhje me këto rreziqe. Ndryshimi kryesor në kuadër të qasjeve për adresimin e këtyre fenomeneve është përfshirja e aspekteve të riintegritimit dhe rehabilitimit në komponentin e reagimit. Mbështetja për viktimat e terrorizmit do të jetë një tjetër aspekt i reagimit ndaj akteve terroriste. Garancia që viktimat e terrorizmit të marrin mbështetjen, njohjen dhe mbrojtjen e nevojshme është një pjesë thelbësore e reagimit ndaj terrorizmit. Në këtë kuadër do të garantohet mundësia e mbështetjes përmes skemave të kompensimit për viktimat e akteve terroriste, duke ngritur kapacitetet për menaxhimin e dhënies së ndihmës viktimave të terrorizmit sipas Konventës Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Terrorizmit.

Riintegrimi dhe rehabilitimi i personave të kthyer nga zonat e konfliktit konsiderohet gjithashtu një aspekt shumë i rëndësishëm për të reaguar ndaj pasojave të rekrutimit dhe indoktrinimit me ideologji të dhunës, dhe veçanërisht vëmendje e veçantë do t'i kushtohet programeve specifike për rehabilitimin e fëmijëve dhe të rinjve. Në këtë kuadër do të zhvillohen trajnime, tryeza pune dhe fushata ndërgjegjësuese dhe informuese për mësuesit e shkollave që trajtojnë ri-

integrimin e fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit, për shërbimin psiko-social e shkollave që trajtojnë ri-integrimin e fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit dhe me subjektet private në këndvështrimin e bashkëpunimit për mundësitë e punësimit e ri-integrimit në komunitetet lokale të kontingjentit të të kthyerve nga zonat e konfliktit.

Për të arritur këtë qëllim politike, do të jetë e nevojshme që të pakësohet rreziku i dëmit nga aktet terroriste përmes krijimit të kapaciteteve, sistemeve efektive kombëtare, koordinimit e bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për parandalimin e radikalizimit, ekstremizmit të dhunshëm, luftën kundër terrorizmit, hetimin dhe mbrojtjen nga aktet terroriste, si edhe për rehabilitimin dhe riintegrimin e individëve të radikalizuar dhe të kthyerve nga zonat e konfliktit.

Detyrë e institucioneve përkatëse është të parashikojnë masa konkrete ligjore, normative apo administrative për të mundësuar vlerësimin dhe ndjekjen e çdo sinjali apo indicie që çon në fenomene terroriste, duke i bërë njëkohësisht objekt analize e bashkëpunimi.

Gjithashtu ndryshimet në strategjinë aktuale parashikojnë edhe plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe normativ për objekte strategjike apo të rëndësishme të vendit, të cilat mbeten në vëmendjen e planeve të individëve apo grupeve terroriste dhe që mund të sjellin pasoja të rënda për vendin.

Një aspekt shumë i rëndësishëm është edhe forcimi i kapaciteteve për monitorimin dhe hetimin e rasteve të radikalizmit dhe kryesisht atij online që çon në terrorizëm dhe në këtë drejtim një rol të rëndësishëm do të marrin masat e parashikuara për krijimin e kapaciteteve hetimore dhe strukturave të posaçme në organizimin strukturor të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me qëllim rikonceptimin e saj si një agjenci të inteligjencës krahas agjencive antiterror, për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm dhe kryesisht atij online. Në këtë drejtim rëndësi të veçantë do të marrë niveli i koordinimit për shkëmbimin e informacionit përmes ngritjes dhe fuqizimit të pozicionit të koordinatorëve për çështje të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, financimit të terrorizmit dhe proceseve RRR në DVP, Prefektura, NJVV-të, DPPP, IEVP, Bashkitë dhe në të gjithë territorin e vendit por edhe kryerjes së vlerësimeve dhe analizave të rreziqeve të financimit të aktiviteteve të propagandës, radikalizmit, nxitjes së ekstremizmit të dhunshëm nga subjekte të ndryshme, analizave të profileve me rrezik financimi të aktiviteteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmi,

identifikimit, profilizimit, grumbullimit dhe analizës së të dhënave rreth individëve në rrezik radikalizimi apo të radikalizuar ose ekstremist të dhunshëm.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim është në përputhje me rendin juridik të brendshëm, konkretisht me nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar në fuqi kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar por ai është në përputhje me Agjendën e Bashkimit Evropian për Luftën Kundër Terrorizmit e cila ka katër shtylla si parashikimi i kërcënimeve, parandalimi, mbrojtja, reagimi Planin e Veprimit Rajonal për Luftën Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor dhe Strategjinë e Sigurisë së Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Strategjia Ndërsektoriale për parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2022 -2025 dhe Planeve të Veprimit për Zbatimin e saj, përbëhet nga 4 kapituj të cilët përfshijnë:

**Pjesa e I**, përmban kontekstin strategjik, qëllimin, kuadrin ligjor, kuadrin institucional, arritjet, vizionin dhe misionin e strategjisë të cilat janë pasuruar edhe me fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.

**Pjesa e II**, përmban shtyllat kryesore strategjike, qëllimin e politikave dhe objektivat specifike të strategjisë. Konkretisht:

Qasja e parë parandaluese ka përfshirë edhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duke ndryshuar titullin në “parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit”. Në qëllimin e politikës 1 të kësaj qasje me titull “Mbajtja e kërcënimit terrorist në nivel “të ulët” objektivi specifik 1.1 ka ndryshuar titullin në “parandalimi *i ekstremizmit të dhunshëm dhe* terrorizmit” dhe është shtuar objektivi specifik 1.5 “Fuqizimi i komuniteteve dhe institucioneve publike për

identifikimin dhe raportimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit”

Në qëllimin e politikës 5 “zhvillimi i komunikimit strategjik”, objektivi specifik 5.2 ka ndryshuar titullin në “Krijimi i një rrjeti komunikimi të vazhdueshëm për shkëmbimin e informacioneve mes institucioneve dhe strukturave të përfshira me qëllim krijimin e mekanizmave për ndërgjegjësimin mbi terrorizmin *dhe ekstremizmin e dhunshëm.*” dhe është shtuar objektivi specifik 5.3 “Komunikimi strategjik dhe kundër-narrativa online e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit”.

Qasja 3 me titull “reagimi” është pasuruar edhe me komponentët e rehabilitimit dhe riintegritimit duke ndryshuar titullin në “reagimi, rehabilitimi dhe riintegritimi”. Qëllimi i politikës 9 të kësaj qasje ka ndryshuar me titull “reagim nëpërmjet reduktimit dhe lehtësimit të pasojave të fenomeneve të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit”. Në këtë qëllim politike janshtuar objektivat specifike si më poshtë:

- objektivi specifik 9.2 “përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve publike për rehabilitimin dhe riintegritimin e personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit”
- objektivi specifik 9.3 “fuqizimi ekonomik i personave të radikalizuar dhe familjeve të kthyer nga vendet e luftës përmes integritimit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve për kualifikime dhe punësim”
- objektivi specifik 9.4 “rritja e aksesit të personave të riintegruar dhe të kthyer nga vendet e luftës në programet e strehimit social”

**Pjesa e III**, përmban masat prioritare të cilat nuk kanë pësuar ndryshime.

**Pjesa e IV**, përmban zbatimin, përgjegjësin e institucioneve, llogaridhënien, raportimin dhe monitorimin, të cilat konkretisht janë:

- Implementimi/zbatimi i strategjisë nuk pësuar ndryshime
- Përgjegjësia e institucioneve dhe angazhimet institucionale. Në këtë kapitull janë përditësuar përgjegjësitë dhe angazhimet institucionale edhe në lidhje me detyrimet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duke përfshirë Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) me miratimin e ligjit nr. 41/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.
- Llogaridhënia dhe raportimi ka përfshirë edhe mekanizmin e monitorimit ku përcaktohet se procesi i monitorimit të Planit të Veprimit të Luftës Kundër Terrorizmit do të koordinohet nga struktura përgjegjëse për hartimin dhe koordinimin e strategjive të rendit dhe sigurisë publike në Ministrinë e Brendshme dhe Plani i Veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm do të koordinohet nga

institucioni përgjegjës që ndjek çështjet e ekstremizmit të dhunshëm në Ministrinë e Brendshme sipas legjislacionit në fuqi.

**Pjesa V**, përmban, planet e veprimit dhe burimet financiare për zbatim.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT**

Ngarkohen me ndjekjen e zbatimit të kësaj strategjie dhe planeve të veprimit, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Informativ Shtetëror, Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe institucionet e tjera përgjegjëse të përmendura në strategji dhe planin e veprimit.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë të rregulluar me vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”. Ky projektvendim është hartuar nga grupi ndër-institucional i punës (GNP) kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm në bashkëpunim me anëtarët e GNP: Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Komiteti Shtetëror për Kultet.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

---


Relacion shpjegues mbi projektvendimin “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021–2025 dhe të planit të veprimit 2021–2023”




Strategjia implementohet përmes dy planeve të veprimit përkatësisht Planit të Veprimit të Luftës Kundër Terrorizmit 2022-2025 dhe Planit të Veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm 2022-2025. Kostot dhe shpenzimet janë detajuar në planet respektive të veprimit sipas programeve buxhetore dhe kodeve të produkteve të PBA 2021-2023 dhe PBA 2023-2025. Kosto e Planit të Veprimit të Luftës Kundër Terrorizmit ka ndryshuar si pasojë e ndryshimit të afateve të aktiviteteve të cilat fillojnë nga viti 2022 dhe shtrihen deri në vitin 2025. Gjithashtu bazuar në ndryshimin e institucionit përgjegjës dhe rishikimit të masave të parashikuara në programin buxhetor të Prokurorisë së Përgjithshme duke i përcaktuar ato tashmë mbi bazën e programit buxhetor “Veprimtaria e SPAK 03390” të Strukturës së Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), kurse programet buxhetore të institucioneve të tjera mbeten të pandryshuara. Financimi i Planit të Veprimit të Luftës Kundër Terrorizmit 2022-2025 (në lekë) paraqitet si më poshtë:

<b>KOSTO TOTALE E PV</b>	3,205,625,015
<b>PBA 2021-2023</b>	1,652,529,338
<b>PBA 2023-2025</b>	1,553,095,677
<b>FINANCIM I HUAJ</b>	0
<b>HENDEK FINANCIAR 2021-2025</b>	0

Kosto totale e Planit të Veprimit është 3,205,625,015 Lekë ku 52% (ose 1,652,529,338 lekë) e të cilit financohet nga PBA 2021-2023 dhe 48% (ose 1,553,095,677 lekë) e tij nga PBA 2023-2025. Aktivitetet e parashikuara janë të financuara plotësisht nga programet buxhetore të institucioneve përgjegjëse dhe nuk ka hendek financiar.



Të gjitha kostot e aktiviteteve janë kosto korrente.



Sipas qëllimeve të politikave kostimi i Planit të Veprimit të Luftës Kundër Terrorizmit 2022-2025 paraqitet si më poshtë vijon:

	<b>Kosto Korentë</b>	<b>Kosto Kapitale</b>	<b>% në raport me koston totale të PV</b>
<b>Qëllimi i Politikës I</b>	472,600,000	0	14.74
<b>Qëllimi i Politikës II</b>	611,338,400	0	19.07


Relacion shpjegues mbi projektvendimin “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektorale të luftës kundër terrorizmit 2021–2025 dhe të planit të veprimit 2021–2023”

<b>Qëllimi i Politikës III</b>	404,025,600	0	12.60
<b>Qëllimi i Politikës IV</b>	50,000,000	0	1.56
<b>Qëllimi i Politikës V</b>	566,338,400	0	17.67
<b>Qëllimi i Politikës VI</b>	945,475,615	0	29.77
<b>Qëllimi i Politikës VII</b>	68,314,000	0	2.13
<b>Qëllimi i Politikës VIII</b>	17,040,000	0	0.53
<b>Qëllimi i Politikës IX</b>	14,000,000	0	0.44
<b>Qëllimi i Politikës X</b>	3,600,000	0	0.11
<b>Qëllimi i Politikës XI</b>	18,576,000	0	0.58
<b>Qëllimi i Politikës XII</b>	3,936,000	0	0.12
<b>Qëllimi i Politikës XIII</b>	21,456,000	0	0.67

Në lidhje me Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2022-2025, Kosto totale e Planit të Veprimit është 52,319,879 Lekë ku 49% (ose 25,534,333) e të cilit financohet nga PBA 2021-2023, 46% (ose 23,970,493 lekë) e tij nga PBA 2023-2025 dhe 5% (ose 2,815,054 lekë) me financim të huaj nga donatorë. Aktivitetet e parashikuara janë të financuara plotësisht nga programet buxhetore të institucioneve përgjegjëse ose me donatorë dhe nuk ka hendek financiar.

<b>KOSTO TOTALE E PLANIT TË VEPRIMIT</b>	<b>52,319,879</b>
<b>PBA 2021-2023</b>	25,534,333
<b>PBA 2023-2025</b>	23,970,493
<b>FINANCIM I HUAJ</b>	2,815,054
<b>HENDEK FINANCIAR 2021-2025</b>	0


### KOSTO E PLANIT TË VEPRIMIT NDARJA E SHPENZIMEVE



Në pjesën më të madhe të tij Plani i Veprimit i Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm 2022-2025 përbëhet nga kosto korrente rreth 97% ose 50,969,879 lekë dhe 3% ose 1,350,000 lekë nga kosto kapitale.



<b>Kosto Korente</b>	<b>50,969,879</b>
<b>Kosto kapitale</b>	1,350,000
<b>Total kosto</b>	52,319,879

### NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË PLANIT TË VEPRIMIT



Sipas qëllimeve të politikave kostimi i Planit të Veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm 2022-2025 paraqitet si më poshtë vijon:

	<b>Kosto Korente</b>	<b>Kosto Kapitale</b>	<b>Totali</b>
<b>Qëllimi i Politikës I</b>	33,870,519	850,000	34,446,519
<b>Qëllimi i Politikës II</b>	17,373,360	500,000	17,873,360



Disa nga projektet kryesore që financojnë dhe mbështesin aktivitetet e Planit të Veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm 2022-2025 janë si më poshtë:

Relacion shpjegues mbi projektvendimin “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektorale të luftës kundër terrorizmit 2021–2025 dhe të planit të veprimit 2021–2023”

- Implementuesi:** IOM  
**Titulli:** Riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer dhe familjeve të tyre nga zonat e konfliktit.  
**Vlera totale** për të gjitha shtetet, vlera e projektit rajonal 1,500,000 euro.  
**Mesatarja për shtet** 300.000 euro.  
**Fonde** IOM dhe EU.  
**Afati i implementimit** 7 gusht 2020 - 6 gusht 2023.
- Implementuesi:** IDM  
**Titulli:** Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria  
**Qëllimi:** Ndërhyrja konsiston në tre komponentë kryesorë: forcim kapacitetesh, bashkëpunim ndërsektorial dhe fuqizim i komuniteteve, të cilat synojnë të krijojnë një mjedis mundësues për institucionet dhe profesionistët e vijës së parë dhe njëkohësisht të forcojnë kohezionin social dhe qëndrueshmërinë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.  
**Vlera totale** për Shqipërinë 50,000,000 lekë.  
**Afati i implementimit** 01 qershor 2021 - 30 nëntor 2023.
- Implementuesi:** SHIS - Shoqata Internacionale për Solidaritetin  
**Titulli:** BRAVE (Building Resilience Against Violent Extremism/Ndërtimi i qëndrueshmërisë kundër ekstremizmit të dhunshëm)  
**Qëllimi:** Ndërtimi i komuniteteve të sigurt dhe elastike ndaj ekstremizmit të dhunshëm, përmes edukimit dhe aktivizmit të të rinjve. Promovimi i partneritetit nxënës-mësues – prindër në 8 shkolla fillore të përzgjedhura në komunitete me rrezik të lartë për t'u përfshirë në veprime të dhunshme ekstremiste dhe mbështetje e nismave ndërgjegjësuere të të rinjve për të rritur qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm.  
**Vlera totale** për Shqipërinë 60,000 dollarë.  
**Fonde:** Ambasada Amerikane në Tiranë  
**Afati i implementimit** tetor 2021 - shtator 2022.
- Implementuesi:** QKEDH. Partner lokal: Adriapol Institute. Ky projekt po zbatohet në partneritet me Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në pesë rajone si Tirana dhe Durrësi, Dibra, Korça, Elbasani dhe Kukësi, me mbështetjen financiare të GCERF-it.  
**Titulli:** Parandalim dhe riintegrim i sigurt. Qasje holistike dhe e qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm  
**Donatori:** GCERF(Global Community Engagement and Resilience Fund)  
**Buxheti:** 50,000,000 lekë  
**Objektivi i përgjithshëm** i projektit është të forcoje qëndrueshmërinë ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes një qasjeje holistike me qëllim

parandalimin e radikalizmit dhe të mbështetet riintegrimin e sigurt të grave dhe fëmijëve që kthehen nga zonat e luftës. Mobilizimi dhe fuqizimi i të rinjve dhe komuniteteve do të jetë një tjetër qasje për ndërtimin e reziliencës për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin. Programet e ngritjes së kapaciteteve dhe metodologjitë e mobilizimit dhe angazhimit të të rinjve do të synojnë të nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në përcaktimin e prioriteteve dhe zbatimin e nismave dhe veprimeve advokuese të dizajnuara nga të rinjtë.

**Afati i implementimit** 01.12.2021-30.12.2022

**Implementues:**

- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza  
Implementim në zonat gjeografike: Tiranë, Bulqizë, Pogradec, Librazhd, Elbasan, Vlorë, Shkodër, në shkallë kombëtare
- Instituti Adriopol  
Implementim në zonat gjeografike: Tiranë, Bulqizë, Pogradec, Librazhd, Elbasan, Vlora, Shkodër
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit  
Implementim në zonat gjeografike: Tiranë, në shkallë kombëtare
- Këshilli Ndërfetar Shqipëri  
Implementim në zonat gjeografike: Tiranë, Bulqizë, Pogradec, Librazhd, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Berat

**Titulli:** Lënia pas e të kaluarës: Ndërtimi i qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes mbështetjes dhe edukimit

**Data e fillimit dhe e përfundimit** 01.06.2021 – 31.05.2024

**Buxheti total** 800,000 dollarë

**PROPOZUESI**

**MINISTRI I BRENDSHËM**

**Bledar Çuçi**